
	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË TREGUT	DT-KO-007
	<i>ver. 2.0</i>	<i>fage 1 nga 10</i>


METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË TREGUT

Prill 2017, Prishtinë

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË TREGUT	DT-KO-007
	<i>ver. 2.0</i>	<i>fajqe 2 nga 10</i>

PËRMBAJTJA

1.0	HYRJE	3
1.1	Qëllimi	3
1.2	Fushëveprimi	3
1.3	Kërkesat ligjore dhe rregullative	3
1.4	Llojet e Tarifave dhe Taksave të OST/OT-së	4
2.0	FONDI PËR BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË ELEKTRIKE	4
3.0	ARANZHIMET KONTRAKTUESE.....	4
4.0	BAZA LIGJORE DHE RREGULLATIVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE	5
4.1	Licenca e Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike (Licenca OT)	5
4.2	Shërbimet e Operatorit të Tregut	6
5.0	TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (MAR)	6
5.1	Parimet e përgjithshme për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale.....	6
5.2	Alokimi i MAR për aktivitete.....	7
6.0	STRUKTURA E TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT	7
6.1	Tiparet kryesore	7
6.2	Baza për përcaktimin e tarifave.....	8
6.3	Formula për llogaritjen e Tarifave të OT	8
6.4	Llojet e tarifave të OT	9
7.0	PËRSHTATJA PËR TEJKALIM/MOSARRITJE TË KTHIMIT TË MAR	9
	SHTOJCA 1: METODOLOGJIA E ALOKIMIT TË KOSOTOVE	10

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË TREGUT	DT-KO-007
	<i>ver. 2.0</i>	<i>faqe 3 nga 10</i>

1.0 HYRJE

1.1 Qëllimi

Ky dokument përmban metodologjinë e cila do të përdoret nga KOSTT gjatë përcaktimit të tarifave që Prodhuesit dhe Furnizuesit i paguajnë për Operatorin e Tregut¹, (Tarifat e OT)

Taksat për kyçje në sistemin e transmetimit janë të rregulluara me Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit, e cila është nxjerrë ndaras nga KOSTT dhe është miratuar nga ZRrE².

1.2 Fushëveprimi

Ky dokument mbulon:

1. Kornizën ligjore dhe rregullative për Tarifat e Operatorit të Tregut;
2. Përkufizimin e shërbimeve të Operatorit të Tregut;
3. Alokimin e kostove për Operatorin e Tregut;
4. Kalkulimin e Tarifave të Operatorit të Tregut

1.3 Kërkesat ligjore dhe rregullative

Kjo Metodologji merr parasysh dhe u përmbahet kërkesave të parashtruara në:


- Ligjin për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Ligjin për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085;
- Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;

Kjo Metodologji gjithashtu është përgatitur në pajtim me dokumentet vijuese:

- Licencën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit;
- Licencën e Operatorit të Tregut;
- Rregullën për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për të hyrat e OST/OT-së);

¹ Prodhuesit dhe Furnizuesit janë përcaktuar me Rregullat e Tregut

² ZRrE është Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË TREGUT	DT-KO-007
	<i>ver. 2.0</i>	<i>faqe 4 nga 10</i>

- Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike;
- Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut si dhe Taksave të Kyçjes.

1.4 Llojet e Tarifave dhe Taksave të OST/OT-së

- **Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit (SHST)** - Mënyra e përcaktimit të këtyre tarifave është vendosur me Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave SHST.
- **Tarifat e Operatorit të Sistemit** - Mënyra e përcaktimit të këtyre tarifave është vendosur me Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit.
- **Tarifat e Operatorit të Tregut** - Mënyra e përcaktimit të këtyre tarifave është vendosur me këtë dokument.
- **Taksat e Kyçjes** - Mënyra e përcaktimit të këtyre taksave është vendosur me Metodologjinë për Përcaktimin e Taksave të Kyçjes në Sistemin e Transmetimit.

2.0 FONDI PËR BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË ELEKTRIKE


Sipas nenit 8 paragrafit 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Operatori i Tregut është përgjegjës për menaxhimin e fondit për BRE:

“Kompensimi, pagesa e energjisë së prodhuar nga burimet e energjisë së ripërtërishme bëhet sipas tarifave për kompensimin e prodhimit të energjisë elektrike nga këto burime të cilat i mbledh Operatori i Tregut nga furnizuesit e konsumatorëve fundorë, me përjashtim të sasisë për të cilën prodhuesit kanë lidhur kontratë për shitje, sipas dispozitave të këtij ligji.”

Forma e mbledhjes dhe menaxhimit të fondit si dhe metodologjia e përcaktimit të tarifës për kompensimin e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE-të është përcaktuar në Rregullën për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve.

3.0 ARANZHIMET KONTRAKTUESE

Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji përcakton kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji për konsumatorët si dhe detyrat dhe obligimet e ndërmarrjeve energjetike dhe konsumatorëve të tyre. Në të përshkruhen edhe parimet e

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË TREGUT	DT-KO-007
	<i>ver. 2.0</i>	<i>fajqe 5 nga 10</i>

përgjithshme të kyçjes dhe shfrytëzimit të sistemit të transmetimit, leximit, matjeve, faturimit dhe inkasimit, si dhe shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë.

Sipas Rregullave të Tregut pagesa e detyrimeve ndaj KOSTT është e obliguar. Rregullat e Tregut përcaktojnë procedurat që duhet ndjekur në rast të kontesteve lidhur me detyrimet apo mos pagesën e tyre.

4.0 BAZA LIGJORE DHE RREGULLATIVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE

Rregulla për Vendosjen e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut përbën bazën për caktimin e Të Hyrave të Lejuara Maksimale në çdo vit përkatës, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut si dhe Taksave të Kyçjes.

Sipas nenit 3 (Rregulla për të Hyrat e OST/OT-së), OST/OT do të propozojë tarifat e për shfrytëzim të rrjetit të transmetimit (SHST), tarifat e operatorit të sistemit (OS), dhe tarifat e operatorit të tregut (OT), ashtu që brenda çdo viti relevant, të hyrat që priten të mbledhë nga këto tarifa do të jenë të barabarta me të hyrat e lejuara maksimale të aprovuara nga rregullatori.

Sipas nenit 21 (Rregulla për të Hyrat e OST/OT-së), OST/OT duhet të propozojë tarifat e OT, në mënyrë që OST/OT të mbulojë kostot e operatorit të tregut për kryerjen e shërbimeve të operatorit të tregut, siç autorizohet me licencën e OT-së;


Sipas nenit 22 (Rregulla për të Hyrat e OST/OT-së), Metodologjia për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Tregut miratohet nga Rregullatori; Këtë metodologji dhe gjitha amendamentet e mëvonshme të saj, OST/OT duhet ti dërgojë për aprovim tek Rregullatori së paku 15 ditë pune³ para datës së propozuar të hyrjes në fuqi të tyre.

4.1 Licenca e Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike (Licenca OT)

Licenca e OT (Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Tregut), i licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për aktivitetin e transmetimit në tërësi, si dhe për aktivitetet tjera. Kontabiliteti rregullativ do të jetë në përputhje me udhëzimet rregullative për kontabilitet të lëshuara nga ZRRE.

Gjithashtu, kjo licencë thekson se baza për ndarjen proporcionale dhe alokimin e ngarkesës nuk do të ndryshojë nga viti financiar në vitin tjetër pa pëlqimin e ZRRE-së dhe miratimin e saj me shkrim të ndryshimeve të tilla.

³ Ditë pune janë të gjitha ditët e javës që me ligjet e Republikës së Kosovës konsiderohet të jenë ditë pune.

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË TREGUT	DT-KO-007
	<i>ver. 2.0</i>	<i>fajqe 6 nga 10</i>

4.2 Shërbimet e Operatorit të Tregut

Sipas licencës së OT-së, KOSTT-i është i autorizuar për kryerjen e aktiviteteve si në vijim:


- Aderojë në Rregullat e Tregut në cilësinë e “pronarit”;
- Mbajë proces për aderim në Rregullat e Tregut për të gjitha Palët Tregtare;
- Administrojë tregun e organizuar të energjisë elektrike;
- Menaxhojë procesin e ndërrimit të furnizuesit;
- Mirëmbajë llogaritë për Operatorin e Tregut, Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe të Palëve Tregtare;
- Përpilojë dhe dorëzojë te Operatori i Sistemit programet ditore të shitblerjes së energjisë elektrike;
- Bëjë shitblerjen e energjisë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë;
- Organizimin e shitblerjes së energjisë balancuese nga ofruesit e shërbimeve që përfshinë grumbullimin e ofertave dhe përpilimin e listës së përparësisë ekonomike;
- Menaxhojë procesin e barazimit përfundimtar;
- Faturojë obligimet reciproke financiare të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Tregut dhe Palëve Tregtare;
- Veprojë si agjent për barazim financiar për Operatorin e Sistemit të Transmetimit;
- Sigurojë informacione mbi tregun e energjisë elektrike; dhe
- Ushtrojë funksione të tjera që i janë caktuar me Rregullat e Tregut.

5.0 TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (MAR)

5.1 Parimet e përgjithshme për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale

Të hyrat që KOSTT mund t'i mbledh përmes tarifave në një vit përcaktohen nga ZRrE përmes proceseve të shqyrtimit të MAR-it. Këto procese përbëhen nga shqyrtimi periodik dhe përshtatjet e rregullta për qëllim të indeksimit të kostove dhe të ardhurave të lejuara dhe përshtatjeve në rast të tejkalimit apo mosarritjes së mbulimit të kostove (shih nenin 3 të Rregullës për të hyrat e OST/OT-së)

Duke ndjekur këto procese, ZRrE përcakton MAR-in për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT), pastaj i alokon këto kosto në secilin aktivitet ndaras për qëllim të përcaktimit të tarifave. Veç kësaj, OST/OT-së i lejohet të pranojë të hyra tjera të parregulluara të cilat përjashtohen gjatë llogaritjes së MAR-it. Këto të Hyra Tjera janë nga burimet në vijim:

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË TREGUT	DT-KO-007
	<i>ver. 2.0</i>	<i>fajqe 7 nga 10</i>

- **Grantet:** ZRrE nuk merr parasysh të hyrat nga grantet në përlogaritjen zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar. Asetet e financuara nga grantet nuk janë të përfshira në Bazën e Aseteve të Rregulluara;
- **Të Hyrat nga kyçjet:** Asetet e kyçjes të financuara nga konsumatori nuk janë të përfshira në zhvlerësimin dhe kthimin e lejuar, respektivisht nuk përfshihen në MAR-in e OST/OT-së. Trajtimi i të hyrave nga kyçjet është i dhënë në Metodologjinë e Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmetimit;
- **Të Hyrat/Shpenzimet nga transiti:** Të hyrat neto, përkatësisht diferenca ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve nga transiti përfshihet në llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale;
- **Të Hyrat nga Alokimi i Kapaciteteve Ndërkufitare:** Të hyrat nga alokimi i kapaciteteve kurdo që ka aktivitetet të tilla do të trajtohen gjatë përcaktimit të hyrave të lejuara maksimale;
- **Të Hyrat nga Shfrytëzimi i Kapaciteteve të Fijeve Optike:** KOSTT në të ardhmen pritet që të ketë të hyra nga dhënia me qira e infrastrukturës së fijeve optike;

5.2 Alokimi i MAR për aktivitetet

Faza e parë e përlogaritjes së tarifave për përdoruesit është që të alokohet MAR i përcaktuar në shqyrtimin periodik/përshtatjet e rregullta tek aktivitetet e veçanta të SHST, Operatorit të Sistemit dhe Operatorit të Tregut. Shtojca 1 përshkruan procesin e alokimit të kostove të OT në hollësi.

6.0 STRUKTURA E TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT


6.1 Tiparet kryesore

Tiparet kryesore të strukturës së tarifave të transmetimit janë të përcaktuara në Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit Transmetimit (neni 7).

Tiparet kryesore të ngarkesave të Operatorit të Tregut janë:

- OST duhet t'i mbulojë tarifat për shërbimet e operatorit të tregut dhe operatorit të sistemit përmes një koeficienti ndarës ndaj gjenerimit dhe furnizimit, varësisht prej pjesëmarrjes së tyre në sasinë e energjisë në transmetim:

Kur nga ky alokim, rezulton që çmimi mesatar vjetor i tarifës së transmetimit të paguar nga generatori të jetë më i madh 0.5 €/MWh, atëherë alokimi në tarifat e OT dhe OS duhet të

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË TREGUT	DT-KO-007
	<i>ver. 2.0</i>	<i>fajqe 8 nga 10</i>

azhurnohet në atë mënyrë që tarifa mesatare e paguar nga gjeneratori nuk do të tejkalojë vlerën prej 0.5 €/MWh.

- Tarifat duhet të përcaktohen në atë mënyrë e cila mundëson diferencimin e kostos për ofrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmetimit, të disponueshëm në nivele të ndryshme të tensionit.
- Tarifat e OT nuk ndryshojnë në raport me nivelin e tensionit në të cilin është bërë kyçja

6.2 Baza për përcaktimin e tarifave

Për të përcaktuar tarifën e OT të aplikueshme për shfrytëzues individualë, duhet të përcaktohet baza e tarifave. KOSTT konsideron se njësitë vijuese janë në pajtim me Parimet e Përcaktimit të Tarifave të Transmetimit:

- OST/OT do të kalkulojë tarifën e OT për çdo vit, para fillimit të vitit relevant tarifor, në pajtim me nenet 21 dhe 22 të Rregullës për të Hyrat e OST/OT.
- Pas miratimit të tarifave nga ZRrE, KOSTT do t'i publikojë tarifën për OT.
- Tarifat do të paguheshin për MWh dhe aplikohen për sasi të mujore të energjisë së matur.
- Kostot për të cilat tarifën janë kërkuar nuk ndërlidhen me lokacionin në sistemin e transmetimit.

6.3 Formula për llogaritjen e Tarifave të OT

Formulat e Tarifave të OT:

$$T-OT_p = A / X_p / (B + C)$$

$$T-OT_{f/sh} = A / X_{f/sh} / D$$


$$T-FBRE=REC / NP_f$$

Përshkrimi dhe njësia:

A – Të Hyrat për OT - **€**

B – Prodhimi i Kyçur në Transmetim – **GWh**

C – Prodhimi i Kyçur në Shpërndarje - **GWh**

	METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË OPERATORIT TË TREGUT	DT-KO-007
	<i>ver. 2.0</i>	<i>fajqe 9 nga 10</i>

D – Shitjet tek konsumatorët fundorë dhe direkt + Humbjet në Shpërndarje – **GWh**

T-OT_p – Tarifa e Operatorit të Tregut për Prodhuesit - €/MWh

T-OT_{f/sh} – Tarifa e Operatorit të Tregut për Furnizuesit dhe Shpërndarjen - **€/MWh**

T-FBRE – Tarifa për fondin e energjisë së ripërtitshme

REC – Kostot për fondin e energjisë së ripërtitshme

NP_r – Shuma e Neto-konsumit të furnizuesve të parashikuar të energjisë

X_p – Faktorët alokues i kostove për prodhuesin e kyçur në transmetim

X_{f/sh} – Faktorët alokues i kostove për furnizuesin dhe shpërndarjen

6.4 Llojet e tarifave të OT

Tabela në vijim paraqet njësitë e shfrytëzuara për caktimin e tarifave, të cilave u bëhet referencë në Rregullat e Tregut (sipas emrit dhe variablave) dhe njësitë matëse në këtë dokument me të cilat ato ndërlidhen.


Emri i Tarifës në Metodologjinë e Tarifave të OT dhe Njësitë	Variabla në Rregullat e Tregut	Emri i Tarifës në Rregullat e Tregut
Tarifa e OT _p (për prodhues) - €/MWh	TPOT	Tarifa e Prodhuesit për Operim të Tregut
Tarifa e OT _{f/sh} (për Furnizues dhe Shpërndarje) - €/MWh	TFOT	Tarifa e Furnizuesit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Operim të Tregut

7.0 PËRSHTATJA PËR TEJKALIM/MOSARRITJE TË KTHIMIT TË MAR

Kjo metodologji e tarifave nuk merr parasysh në mënyrë eksplicite çfarëdo tejkalimi/mosarritje të MAR (apo elementeve të MAR të cilat i atribuohen aktiviteteve të OST/OT) në vitin relevant. Mekanizmi për përshtatjen e nën mbulimit apo mbi mbulimit të MAR është i përfshirë në kalkulimin e të hyrave të lejuara maksimale për vitin në relevant tarifor, në bazë të përcaktimit në Rregullën për të Hyrat e OST/OT-së.

SHTOJCA 1: ALOKIMI I KOSTOVE

Në figurën e mëposhtme është paraqitur parimi i alokimit të kostove sipas aktiviteteve: Shrytëzimi i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit dhe Operatori i Tregut.



- fundi i dokumentit -